



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

EDICION SPECIAL I BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË TRENDËT E PERCEPTIMEVE TË QYTETARËVE PËR POLICINË E KOSOVËS KUNDREJT REALITETIT (2015-2018)



Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Interpretimi i të dhënave: Plator Avdiu

Redaktimi i jashtëm: Garentina Kraja

Prishtinë
Maj 2018

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose tjetër, pa lejen paraprake të botuesit.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit "Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP)" i financuar nga Zyra Zvicerrane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmajtja e këtij botimi është përgjegjësi e QKSS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së dhe KCSF-së.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

EDICION SPECIAL I BAROMETRIT KOSOVARTË SIGURISË

**TRENDËT E PERCEPTIMEVE TË QYTETARËVE
PËR POLICINË E KOSOVËS
KUNDREJT REALITETIT (2015-2018)**

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
KAPITULLI 1	
BESUESHMËRIA NË POLICINË E KOSOVËS.....	7
1.1. Frekuenca e kontakteve të qytetarëve me Policinë e Kosovës.....	16
KAPITULLI 2	
PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR INTEGRITETIN NË POLICINË E KOSOVËS.....	18
2.1. Rekrutimi në Policinë e Kosovës	19
2.2. Korrupsioni në Policinë e Kosovës.....	21
2.3. Perceptimet e qytetarëve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit policor.....	27
2.4. Mbrojtja e interesit publik nga Policia e Kosovës	30
SHTOJCA MBI METODOLOGJINË.....	32
BIBLIOGRAFIA.....	33

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës.....	9
Figura 2 – Trendët e besueshmërisë për Policinë e Kosovës (sipas zonave rurale dhe urbane të Kosovës)	10
Figura 3 - Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas rajoneve të Kosovës)	12
Figura 4 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas përkatësisë etnike)	14
Figura 5 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas gjinisë)	15
Figura 6 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas grup-moshave).....	15
Figura 7 - Kontakti i drejtpërdrejtë i qytetarëve me Policinë e Kosovës (2015)	17
Figura 8 - Kontakti i drejtpërdrejtë i qytetarëve me Policinë e Kosovës në 12 muajt e fundit (2016-2017)	17
Figura 9 - Përzgjedhja e kandidatëve për punësim në Policinë e Kosovës.....	21
Figura 10 - Korrupsioni në Policinë e Kosovës.....	25
Figura 11 - Korrupsioni në njësitë e Policisë së Kosovës.....	26
Figura 12 - Kujt së pari do t'i raportoni për korrupsion në Policinë e Kosovës?	27
Figura 13 - Kush duhet ta luftojë korrupsionin në Policinë e Kosovës?.....	29
Figura 14 - Kujt do t'i drejtoheshit për t'u ankuar nëse keni informacione se policët kanë bërë shkelje disiplinore?	30
Figura 15 - Kujt i shërben Policia e Kosovës?	31

LISTA E SHKURTESAVE

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë vlerëson se integriteti është një nga dimensionet më të domosdoshme të qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë në Kosovë. Andaj, ky botim i veçantë (edicion special) i Barometrit Kosovar të Sigurisë analizon dhe zbërthen trendët e perceptimit të qytetarëve të Kosovës për integritetin në institucionin e Policisë së Kosovës përgjatë tri viteve të fundit – 2015, 2016 dhe 2017.

Për Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë është thelbësore që në Barometrin Kosovar të Sigurisë të përfshihen një sërë pyetjesh që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me integritetin, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e zyrtarëve policorë në Kosovë. E veçanta e këtij publikimi është se për herë të parë në Kosovë publikohet një raport hulumtues që analizon trendët e perceptimeve të qytetarëve të vendit për integritetin në Policinë e Kosovës. Si i tillë, raporti është përmbledhje e thukët e opinionëve të të anketuarve ndaj çështjeve të ndryshme që lidhen me këtë institucion të rendit dhe sigurisë.

Ky raport është i ndarë në dy kapituj të cilët shqyrtojnë çështje të ndryshme me interes për Policinë e Kosovës, veçanërisht mendimet, bindjet dhe pikëpamjet e qytetarëve për këtë institucion.

Në kapitullin e parë janë përmbledhur është më i përgjithshëm dhe në të janë përmbledhur të gjitha perceptimet e të anketuarve për besueshmërinë në Polici. Në këtë kapitull janë kombinuar metodat kuantitative dhe kualitative për të interpretuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe analitike mendimet e qytetarëve për Policinë e Kosovës gjatë tri viteve të fundit (2015-2017). Rrjedhimisht, aty janë të pasqyruara opinionet për besueshmërinë në nivel të vendit, sipas zonave të vendbanimit (zonat rurale dhe urbane), sipas rajoneve të Kosovës, sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, sipas gjinisë dhe sipas grup-moshave (prej moshës 18 vjeç e tutje). Gjithashtu, në kuadër të kapitullit të parë është matur edhe frekuenca e kontakteve të drejtpërdrejta të të anketuarve me Policinë e Kosovës në forma të ndryshme.

Ndërkaq, kapitulli i dytë i raportit analizon çështjet e integritetit brendapërbrenda Policisë së Kosovës dhe mënyrën se si i perceptojnë të anketuarit sfidat me të cilat përballen institucioni i Policisë. Këto sfida janë: rekrutimi i kandidatëve për punësim, shkalla e përhapjes së korrupsionit në Polici dhe në sektorë të brendshëm të institucionit, parandalimi dhe luftimi i korrupsionit policor, si dhe opinionet e qytetarëve se në interes të kujt shërben Policia e Kosovës. Përveç pjesëve të veçanta në këtë kapitull, ku në mënyrë kuantitative dhe kualitative interpretohen të dhënat e Barometrit Kosovar të Sigurisë për integritetin policor, po ashtu konstatohet gjendja aktuale dhe reflektohet monitorimi i bërë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë në lidhje me sfidat e qeverisjes së brendshme të Policisë.

KAPITULLI 1

BESUESHMËRIA NË POLICINË E KOSOVËS

Perceptimi i qytetarëve të Kosovës ndaj Policisë së Kosovës (PK) ka vazhduar të jetë pozitiv gjatë tri viteve të fundit. Në këtë raport pasqyrohen të dhënat e Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) për vitet 2015, 2016 dhe 2017 si përmbledhje analitike e trendëve të këtyre tri viteve gjatë të cilave është shënuar kryesisht opinion pozitiv për institucionin e PK-së. Për më tepër, krahasimi i të dhënave përgjatë viteve tregon që derisa në vitin 2015 dhe 2016 besueshmëria e qytetarëve në këtë institucion ishte 56 përqind, në vitin 2017 ishte shënuar rritje e besimit prej gjashtë përqind, duke arritur nivelin e besueshmërisë në 62 përqind të të anketuarve. Si rrjedhojë, mund të thuhet se në vitin 2017 është shënuar rritja më e madhe deri më tash për PK-në duke e mbajtur këtë institucion edhe më tutje në mesin e më të besueshmeve nga ana e të anketuarve (pas Forcës së Sigurisë së Kosovës e cila gëzon besueshmërinë e 78 përqind të të anketuarve).¹

Si duket, në këtë rritje graduale të besueshmërisë në PK gjatë tri viteve të fundit kanë ndikuar faktorë të ndryshëm. Fillimisht, një pjesë e madhe e aktiviteteve të Policisë gjatë viteve të fundit kanë qenë të përqendruara në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në vend. Që nga viti 2012 deri në fund të vitit 2017 rreth 403² qytetarë të Kosovës kanë shkuar në Siri dhe Irak si luftëtarë të huaj apo si familjarë të tyre për t'ju bashkangjitur organizatave terroriste si ISIS. Gjatë kësaj periudhe, PK-ja në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit ishte vënë në veprim në identifikimin e rekrutuesve dhe nxitësve të tjerë që në forma të ndryshme kishin ndikuar në shkuarjen e qytetarëve si luftëtarë të huaj në ISIS, por edhe në arrestimin e atyre që ishin rikthyer në vend nga Siria dhe Iraku. Këto veprime vlerësohet se kanë ndikuar që PK-ja ta ruaj dhe ta rris besimin te të anketuarit e BKS, duke e vënë në pah rolin kyç të këtij institucioni të sigurisë në luftimin e dukurive negative, përfshirë aktivitetet që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm dhe ofrimit të sigurisë publike për qytetarët.

Derisa në vitin 2015 dhe 2016, PK-ja ka qenë më tepër e orientuar në aktivitetet për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, gjatë vitit 2017 ky institucion ka bërë përpjekje të shtuara në parandalimin dhe luftimin e krimeve të rënda, krimin ekonomik dhe korrupsionit në vend. Për shembull, në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, sipas të dhënave

1 (Vrajolli, 2018, f. 12).

2 (Perteshi, 2018, f. 9).

të PK-së, në vitin 2017 janë realizuar 100 operacione policore, janë neutralizuar tri grupe kriminale, janë arrestuar 203 persona dhe Policia ka ngritur 82 kallëzime penale. Ndërsa, në lidhje me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e trafikimit me narkotikë janë ndërmarrë 788 operacione, janë neutralizuar 17 grupe kriminale, 1426 persona janë arrestuar ndërkohë që janë ngritur 1022 kallëzime penale ndaj 1358 personave. Krahas këtyre aktiviteteve, PK-ja në vitin 2017 ka konfiskuar një sasi të konsiderueshme të narkotikëve (të llojit heroinë, kokainë, ekstazi, marihuanë, si dhe bimë dhe fara kanabis). Ndërkohë, statistikat e PK-së tregojnë se kundër krimeve ekonomike, korrupsionit dhe pasurisë së paligjshme në vitin 2017 janë hetuar gjithsej 607 raste nga PK-ja, janë ngritur 370 kallëzime penale, 91 persona janë arrestuar si të dyshuar, 9 operacione e 29 plane operative policore janë realizuar dhe 7 grupe të organizuara kriminale janë neutralizuar.³ Sipas këtyre të dhënave të PK-së për vitin 2017, mund të thuhet se këto aktivitete policore të cilat sipas rasteve të caktuara janë paraqitur edhe publikisht në opinion mund të ndikojnë në rritjen e besueshmërisë së publikut për PK-në.

Një tjetër arsye që shpjegon trendin pozitiv të besueshmërisë ndaj PK-së është edhe respekti që kanë qytetarët e vendit për uniformën si dhe ruajta e rendit dhe qetësisë publike gjatë protestave të ndryshme që janë organizuar veçanërisht në Prishtinë gjatë viteve 2015 dhe 2016 nga partitë e atëhershme opozitare⁴ që kundërshtonin disa prej politikave të Qeverisë⁵ së Kosovës. Përkundër dyshimeve të ngritura nga mekanizma vendorë dhe ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut (Avokati i Popullit dhe organizata ndërkombëtare Amnesty International) se PK-ja në raste të caktuara kishte përdorur forcë të tepruar ndaj protestuesve, me theks të veçantë gjatë dhe pas protestës së opozitës më 28 nëntor 2015⁶, megjithatë kjo nuk duket të ketë lëkundur besimin e qytetarëve të Kosovës në forcat e rendit.⁷ Krahas kësaj, performanca e PK-së nëpër protesta nga qytetarët ishte perceptuar si e viktimizuar në raport me incidentet e ndryshme gjatë tubimeve dhe protestave të ndryshme gjatë këtyre viteve. Prandaj, mund të thuhet që pavarësisht mangësive të PK-së në menaxhimin e turmave me rastin e protestave jo vetëm që është ruajtur niveli i besueshmërisë, por edhe është rritur gjatë vitit 2017 në krahasim me dy vitet paraprake (2015 dhe 2016).

3 (Policia e Kosovës, b, f. 10-11).

4 Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe NISMA Socialdemokrate, e cila më parë njihet si NISMA për Kosovën.


5 Atë kohë (gjatë viteve 2015 dhe 2016) koalicioni qeveritar përbëhej prej PDK-së, LDK-së dhe subjekteve politike të komuniteteve pakicë në Kosovë.

6 Në këtë rast bëhet fjalë për protestën e organizuar nga subjektet opozitare kundër dy marrëveshjeve të negociuara nga ana e Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht Marrëveshja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe Marrëveshja e Demarkacionit me Malin e Zi.

7 Për më shumë detaje sa i përket operacionit policor gjatë dhe pas protestës të datës 25 nëntor 2015, shih: (Avdiu & Perteshi, 2016, f. 35-38).

Sa i përket qeverisjes së mirë brenda PK-së, në vazhdimësi është raportuar nga mekanizmat e jashtëm që mbikëqyrin Policinë (Inspektorati Policor i Kosovës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe organizatat joqeveritare që monitorojnë PK-në dhe) për sfidat në fuqizimin e integritetit institucional, veçanërisht sa i përket luftimit të korrupsionit në këtë institucion dhe dukurive tjera negative që bien ndesh me ligjin.⁸ Për rrjedhojë, pavarësisht popullaritetit të PK-së, ky institucion ende përballlet me probleme të brendshme sa i përket qeverisjes së mirë. Kjo tërthorazi nënkupton se shkalla e lartë e besueshmërisë ose perceptimi pozitiv i të anketuarve për Policinë nuk është domosdoshmërisht dëshmi për gjendjen reale brenda institucionit duke marrë parasysh sfidat për fuqizimin e integritetit policor për të cilat do të flitet në pjesët tjera të këtij raporti.⁹

Figura 1 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës




Rezultatet e BKS-së për periudhën 2015-2017 tregojnë se zonat rurale në Kosovë kanë tendencë më të madhe për t'i besuar PK-së në krahasim me zonat urbane. Rrjedhimisht, mbi 60 përqind e të anketuarve nga zonat rurale përgjatë këtyre tri viteve janë shprehur se i besojnë Policisë, ndërsa në zonat urbane situata duket të ketë më shumë nuanca. Derisa në vitin 2015, rreth 51 përqind e të anketuarve i besonin Policisë, në vitin 2016 ishte shënuar një rënie e lehtë duke e renditur besueshmërinë në 50 përqind, ndërsa në vitin 2017 besueshmëria e të anketuarve për PK-në në zonat urbane ishte rritur në 59 përqind.

8 (Muji & Avdiu, 2017, f. 14-30).

9 Kontribute të mbledhura nga punëtorja e organizuar nga QKSS-ja me temën "Qeverisja e mirë në sektorin e sigurisë – roli i shoqërisë civile", 17-19 mars 2017, Durrës.

Figura 2 – Trendët e besueshmërisë për Policinë e Kosovës (sipas zonave rurale dhe urbane të Kosovës)



Në BKS, niveli i perceptimeve publike është vlerësuar edhe në bazë të rajoneve të Kosovës ku operojnë Drejtoritë Rajonale të Policisë (DRP). Qëllimi i kësaj matje është për të kuptuar më qartë se në cilat nga 8 rajonet e saja, Policia gëzon më pak ose më shumë besueshmëri nga opinioni publik.

Vlen të përmendet që Mitrovica (duke mos e përfshirë në këtë rast pjesën veriore të këtij qyteti të populluar kryesisht nga komuniteti serb) është rajoni që më së shumti i beson PK-së në tri vitet e fundit. Sipas rezultateve, edhe pse në vitin 2016 ishte shënuar rënie e besimit të PK-së në raport me vitin 2015 (prej 74 përqind më 2015 në 62 përqind më 2016, pra një rënie besimi prej 12 përqind), megjithatë më 2017, në rajonin e Mitrovicës, jo vetëm që ishte rikthyer besimi në Polici, por ishte rritur në masë të konsiderueshme në 78 përqind (16 përqind më shumë në krahasim me rezultatin e vitit 2016). Kjo shkallë e lartë e besueshmërisë në Polici në rajonin e Mitrovicës, ndër të tjera, mund të ndërlidhet ngushtë edhe me situatën e sigorisë në Mitrovicë, e cila kohë pas kohe ka qenë e tensionuar shkakun e incidenteve të ndryshme në këtë pjesë të Kosovës kryesisht në veri të lumit Ibër. Si rrjedhojë, të anketuarit nga pjesa jugore e Mitrovicës (përfshirë edhe komunat tjera që mbulohen nga rajoni i Mitrovicës) mund të kenë perceptim pozitiv në punën e PK-së si garantuese e sigorisë dhe rendit publik në këtë rajon, i cili në krahasim me rajonet tjera, ka qenë më shumë i ekspozuar ndaj rrezikut të sigorisë dhe tensionimit të situatës si pasojë e ndikimit të Serbisë dhe politikës së saj në veri të Kosovës.

Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, rajoni i dytë në Kosovë që më së shumti i ka besuar PK-së gjatë viteve 2015-2017 është ai i Prishtinës. Pas kryeqytetit renditet rajoni i Gjakovës, i Pejës, i Prizrenit, i Gjilanit dhe i Ferizajt.

Nga ana tjetër, rajoni i Mitrovicës së veriut të Kosovës, ku përfshihen komuna të banuara kryesisht nga komunitetin serb, si Mitrovica e veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, edhe në vitin 2017 ka treguar të njëjtin nivel të besimit sikur në vitin 2016 me vetëm një përqindje të vogël të besueshmërisë ndaj PK-së, ku asnjëherë nuk tejkaloi 10 përqindshin e të anketuarve në këtë rajon. Gjatë vitit 2015, rreth 27 përqind e të anketuarve nga këto komuna i besonin PK-së, por gjatë vitit 2016 ishte shënuar rënie drastike e besimit. Duke marrë parasysh që komunat veriore të Kosovës i besojnë më së paku PK-së, rrjedhimisht edhe numri i atyre që nuk kanë besim në punën e Policisë është tepër i lartë. E shprehur në statistika, ky trend tregon se gjatë vitit 2017 rreth 58 përqind e të anketuarve nga këto komuna nuk i besojnë aspak PK-së dhe ky është rezultati më negativ që ka shënuar ndonjëherë Policia në veri të Kosovës në raport me vitet paraprake sa i përket besueshmërisë dhe perceptimeve publike në këtë pjesë të vendit (më 2015 rreth 24 përqind e tyre nuk i besonin PK-së, ndërsa më 2016 kjo shkallë e mosbesimit ishte rritur në 44 përqind).

Ky besim kaq i ulët i PK-së në komunat e veriut të Kosovës nuk duhet të shihet si rast i izoluar, por ky është perceptimi i përgjithshëm i komunitetit serb në veri të Kosovës ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës në përgjithësi. Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera shtetërore nuk kanë arritur të shtrijnë autoritetin e tyre në veri të vendit dhe prania e tyre në atë pjesë është e kufizuar shkaku i refuzimit të komunitetit serb për t'u integruar në institucionet shtetërore të Kosovës. Ky qëndrim i serbëve të veriut është kryesisht i ndikuar nga deklaratimet politike dhe kërcënimet e vazhdueshme të zyrtarëve të Beogradit të cilat gjatë vizitave të tyre në Kosovë kanë kërkuar nga komuniteti serb në Kosovë të mos pranojnë të integrohen dhe të bëhen pjesë e institucioneve të sigurisë në Kosovë, si dhe institucioneve të tjera.

Përkundër këtyre sfidave të ndryshme, krerët e PK-së nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (DPP) në Prishtinë kanë ngritur shqetësime serioze për punën dhe performancën e brendshme të DRP-së në Mitrovicë të veriut në raport me luftimin e krimit në atë pjesë të Kosovës që është nën përgjegjësinë e kësaj drejtorie. Në një letër të Drejtorit të Departamentit për Operacione të PK-së, Rashit Qalaj, drejtuar komandantit të DRP-së në Mitrovicë të veriut, Nenad Gjuriq dhe vartësve të tij më 26 prill 2018 thuhet se pavarësisht që në veri të Kosovës janë shtuar dukshëm incidentet e rënda (incidente zjarri, zjarrëvënie, shpërthime me granata dore), këto raste nuk janë zbardhur dhe kryesit e tyre nuk janë sjellur para drejtësisë. Në letër, ndër të tjera, adresohet edhe çështja e mosbesimit: *“si pritët që të rritet besimi nga popullata për Policinë kur rezultati i këtyre hetimeve të rasteve të rënda është zero”*.¹⁰ Nisur nga ky konstatim i krerëve të PK-së mund të konkludohet që një prej arsyeve për besimin tepër të ulët të Policisë në veri të Kosovës është edhe performanca e dobët e DRP-së në Mitrovicë të veriut në luftimin e krimit.

10 (Kosova Press, 2018).

Figure 3 - Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas rajoneve të Kosovës)

		Besoj	Deri diku	Nuk besoj
Prishtinë	2015	59%	20%	21%
	2016	57%	26%	17%
	2017	65%	21%	15%
Mitrovicë	2015	74%	19%	8%
	2016	62%	25%	13%
	2017	78%	10%	12%
Gjilan	2015	56%	22%	23%
	2016	60%	15%	24%
	2017	58%	29%	13%
Pejë	2015	53%	25%	23%
	2016	44%	30%	26%
	2017	63%	21%	16%
Gjakovë	2015	43%	37%	20%
	2016	64%	29%	7%
	2017	63%	27%	10%
Prizren	2015	55%	20%	25%
	2016	54%	24%	21%
	2017	62%	24%	14%
Ferizaj	2015	56%	24%	20%
	2016	63%	19%	18%
	2017	57%	21%	21%
Mitrovica e veriut	2015	27%	49%	24%
	2016	10%	46%	44%
	2017	10%	33%	58%

Interpretimi i rezultateve të besueshmërisë në PK sipas përkatësisë etnike të të anketuarve jep një pasqyrë edhe më të qartë sa i përket perceptimit publik për këtë institucion gjatë tri viteve të fundit. Shqiptarët, si popullatë shumicë në Kosovë, në masë të madhe i beson PK-së, ndërsa statistikisht tregojnë se në vitin 2017 ka rritje të besimit në raport me vitet e kaluara.

PK-së më së shumti i besojnë komunitetet pakicë jo-serbe (komunitetin turk, romë, ashkali, egjiptian, goran, kroat dhe malazez në Kosovë). Siç tregojnë rezultatet e mëposhtme, gjatë vitit 2015 rreth 60 përqind e të anketuarve nga radhët e komuniteteve pakicë jo-serbe i besonin PK-së, ndërsa në vitin 2016 ky besim pësoi rënie të lehtë për tre përqind më pak, gjegjësisht 57 përqind gjithsej. Por, më 2017 perceptimi pozitiv për PK-në u rrit ndjeshëm, me rreth 20 përqind më lart në krahasim me vitin 2016. Përkatësisht 76 përqind e të anketuarve pjesëtarë të komuniteteve pakicë jo-serbe u deklaruan se i besojnë Policisë.


Në anën tjetër, perceptimet e komunitetit serb në veçanti në Kosovë sa i përket PK-së paraqesin një pasqyrë krejtësisht ndryshe. Siç ka treguar praktika në vitet e kaluara, edhe në vitin 2017 ka vazhduar pothuajse trendi i njëjtë i një besueshmërie të ulët të komunitetit serb ndaj PK-së ndonëse me disa dallime të vogla ndërmjet viteve. Në krahasim më popullatën shumicë shqiptare dhe komunitetet pakicë jo-serbe në Kosovë, vetëm 29 përqind të të anketuarve të komunitetit serb në vitin 2015 ishin deklaruar se i besonin PK-së. Në vitin 2016 ky besim ishte lëkundur për 10 përqind më pak, gjegjësisht vetëm rreth 20 përqind i besonin Policisë, kurse në vitin 2017 ishte shënuar një ngritje e lehtë e besimit për 5 përqind, me gjithsej 25 përqind të të anketuarve të komunitetit serb në Kosovë që i besonin PK-së.

Anketimi me qytetarët e komunitetit serb është bërë jo vetëm në komunat veriore të Kosovës, por në të gjithë Kosovën, përfshirë komunat në rajone të ndryshme (në zona rurale dhe urbane) të Kosovës në të cilat jetojnë dhe veprojnë serbët e Kosovës. Në këtë drejtim, komuniteti i cili jeton në rajonet të tjera të Kosovës dhe jo në veri të vendit ka prirje për t'i besuar PK-së se sa serbët e veriut. Kjo tregon se aty ku komuniteti serb është më i integruar në Kosovë është edhe më pozitiv ndaj punës së PK-së (dhe institucioneve tjera të Kosovës) sa i përket ofrimit të sigurisë së përgjithshme të tyre. Ndërsa, sa i përket komunitetit serb në veri të Kosovës janë ngarkesat politike ato që ndikojnë më shumë në bindjet e pjesëtarëve të këtij komuniteti për të qenë mosbesues ndaj Policisë. Me gjithë faktin që komuniteti serb është i përfaqësuar mirë në PK, me rreth 13 përqind të personelit të Policisë që përbëhet prej serbëve të Kosovës¹¹, kjo prani vetvetiu nuk ka nënkuptuar edhe ndryshimin e qëndrimeve të këtij komuniteti ndaj PK-së si institucion i sigurisë dhe rendit publik. Në të vërtetë, besimi i ulët ose mosbesimi i thellë i komunitetit serb ndaj PK-së, por edhe ndaj institucioneve të tjera


11 (Policia e Kosovës, b, f. 13).

të Kosovës lidhet ngushtë me varësinë e përfaqësuesve politikë të serbëve të Kosovës ndaj Serbisë. Krahas kësaj, refuzimi për t'i njohur institucionet e Kosovës dhe ndikimi i drejtpërdrejtë i Serbisë te komuniteti serb në Kosovë qoftë edhe përmes trysnisë për të mos i pranuar institucionet shtetërore të Kosovës, ka ndikuar që ky komuniteti të ketë besim shumë të ulët te të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës pa dallim.


Figura 4 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas përkatësisë etnike)



Opinionet e të anketuarve për PK-së sipas gjinive tregojnë që gratë në Kosovë i besojnë këtij institucioni më shumë në krahasim me burrat. Trendët tregojnë që përgjatë tri viteve të fundit ekziston një dallim gjinor sa i përket perceptimit për Policinë. Në vitin 2015 rreth 61 përqind e grave i besonin PK-së, ndërsa 51 përqind e burrave shprehën besim për këtë institucion (dallimi ishte 10 përqind). Ndërsa në vitin 2016 ky dallim mes dy gjinive ishte zvogëluar në katër përqind (nga 57 përqind te gratë në 53 te burrat). Kurse, më 2017, ky hendek ishte zvogëluar edhe më shumë me 63 përqind e grave të anketuara që i besojnë PK-së, ndërsa rreth 60 përqind të burrave kishin perceptim kryesisht pozitiv për punën e PK-së (dallimi ishte zvogëluar në rreth dy përqind).

Figura 5 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas gjinisë)

Nga ana tjetër, interpretimi i të dhënave statistikore nga aspekti i grup-moshave të të anketuarve shpalosë dallimet ndërmjet gjeneratave sa i përket perceptimit për PK-në. Të anketuarit që i përkasin grup-moshës prej 35 vjeç e tutje kanë prirje t'i besojnë më shumë PK-së sesa të anketuarit e grup-moshave më të reja nga 18-35 vjeç. Rrjedhimisht, në vitet 2015 dhe 2016 dallime ndërmjet gjeneratave ishin relativisht të vogla (deri në 3 përqind). Por dallimi më i theksuar ishte shënuar më 2017 prej tetë përqind (nga 64 përqind e atyre që ishin mbi grup-moshën 35 vjeç në 56 përqind e të anketuarve të grup-moshave më të reja që i besonin më pak PK-së).

Figura 6 – Trendët e besueshmërisë në Policinë e Kosovës (sipas grup-moshave)

1.1. Frekuenca e kontakteve të qytetarëve me Policinë e Kosovës

Perceptimi i të anketuarve nga BKS për PK-në bëhet më i qartë kur këto përshtypje janë krijuar në bazë të kontaktit të drejtpërdrejtë me institucionin e Policisë. Rezultatet tregojnë se gjatë viteve të fundit (me përjashtim të vitit 2017) qytetarët e konsiderojnë PK-në si institucionin të cilin do të kontaktonin së pari për çështje të ndryshme, përfshirë edhe ato të sigurisë. Kjo do të thotë se një pjesë e perceptimeve të të anketuarve për PK-në janë të bazuara në kontaktet e drejtpërdrejta ose përvojave personale të tyre me këtë institucion të sigurisë.


Para se të kalohet në pjesën e perceptimeve është e rëndësishme të përmendet një çështje metodologjike sa i përket pyetjes për frekuencën e kontakteve të qytetarëve me PK-në. Në vitin 2015 ishte shënuar frekuencë më e lartë e kontakteve të qytetarëve me PK-në, derisa në vitet 2016 dhe 2017 përqindja e të anketuarve që kishin pasur kontakte me këtë institucionin kishte rënë dukshëm. Kjo kishte ndodhur për shkak se më 2015 të anketuarit ishin pyetur për çfarëdo kontakti të përgjithshëm që mund të kenë pasur me Policinë pa e kufizuar në kohë (gjegjësisht në dymbëdhjetë muajt e fundit të vitit 2015). Ndërsa, në vitin 2016 dhe 2017 kjo ishte kufizuar në aspektin kohor sa i përket frekuencës së kontakteve të të anketuarve me PK-në. Më saktësisht, të anketuarit ishin pyetur nëse kanë pasur kontakt me Policinë gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Kjo është arsyeja që rezultatet për vitin 2015¹² janë ndarë nga rezultatet për vitin 2016 e 2017¹³ dhe si të tilla rezultatet e dy viteve të fundit duhet të shihen si të ndara prej atyre të vitit 2015.

Pra, në vitin 2015 të anketuarit ishin pyetur për frekuencën e kontaktit të tyre të drejtpërdrejtë me PK-në dhe më shumë e gjysma e tyre kishin pranuar se kanë pasur kontakt të tillë. Për më tepër, rreth 58 përqind e tyre ishin përgjigjur se kishin pasur kontakt të drejtpërdrejtë, ndërsa 42 përqind të tjerë ishin shprehur se nuk kanë pasur ndonjë kontakt me PK-në gjatë vitit 2015. Në perceptimin e tyre të përgjithshëm në lidhje me këtë institucion mund të ketë ndikuar edhe vetë natyra e punës së PK-së, e që ngërthen mbrojtjen e jetës dhe ofrimin e sigurisë së përgjithshme për të gjithë njerëzit në Kosovë.¹⁴

¹² Shih Figurën 7.


¹³ Shih Figurën 8.

¹⁴ Për më shumë hollësi, shih Nenin 10 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.

Figura 7 - Kontakti i drejtpërdrejtë i qytetarëve me Policinë e Kosovës (2015)

Në vitin 2016 dhe veçanërisht gjatë vitit 2017 frekuenca e kontaktit të të anketuarve me PK-në kishte rënë ndjeshëm. Kjo për shkak se, siç u përmend më lartë, që prej edicionit të vitit 2016 të BKS-së kjo pyetje ishte riformuluar dhe kontakti i drejtpërdrejtë me PK-në është kufizuar në aspektin kohor për të përfshirë dymbëdhjetë muajt e fundit.

Si pasojë e këtij kufizimi kohor, vërehet një rënie e ndjeshme e kontaktit të të anketuarve me Policinë. Gjegjësisht gjatë vitit 2016 më pak se 30 përqind e qytetarëve kishin pasur kontakt të drejtpërdrejtë me PK-në, ndërsa në vitin 2017 ka pasur rënie drastike të kontaktit, ku gjithsej 5 përqind prej të anketuarve kishin pasur kontakt me Policinë.

Figura 8 - Kontakti i drejtpërdrejtë i qytetarëve me Policinë e Kosovës në 12 muajt e fundit (2016-2017)

KAPITULLI 2

PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR INTEGRITETIN NË POLICINË E KOSOVËS

Fuqizimi i integritetit brenda PK-së manifestohet përmes luftës kundër korrupsionit dhe forcimit të mekanizmave të brendshëm në drejtim të parandalimit, zvogëlimi dhe luftimit të korrupsionit dhe dukurive të tjera negative me qëllim të qeverisjes së mirë brenda institucionit. Sa i përket integritetit policor, PK-ja ka hartuar Kodin e Etikës, por ky dokument nuk dihet se çka përmban meqë ky dokument nuk është bërë publik, gjegjësisht nuk është i publikuar në ueb-sajtin e PK-së.

Një dokument tjetër i rëndësishëm është Plani i Integritetit që është hartuar nga PK-ja tek në vitin 2017 i cili vlen për një periudhë dyvjecare të zbatimit (2018-2019) për fuqizimin e integritetit. Qëllimi i tij është fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe zvogëlimi i dukurive të mundshme negative që mund të cenojnë integritetin e PK-së.¹⁵ Ky dokument është i bazuar në disa prej parimeve bazë të integritetit, siç janë parimi i profesionalizmit, besueshmërisë, lirive dhe të drejtave të njeriut, transparencës, integritetit dhe përkatësisë.¹⁶ Për më tepër, Policia është zotuar ta përfshijë konceptin e integritetit brenda kornizës së saj udhëheqëse dhe si norma e cila do të aplikohet në të gjitha nivelet e institucionit të PK-së.

Në fazën e hartimit të Planit të Integritetit grupet punues të PK-së kanë bërë vlerësimin e rrezikut në ato fusha që janë konsideruar se cenojnë integritetin policor, ndërsa janë propozuar edhe masa konkrete për reduktimin dhe eliminimin e parregullsive si pasojë e cenimit të integritetit.

Në këtë mënyrë, fushat më të cenueshme brenda PK-së janë konsideruar (i) fusha e hetimeve e PK-së, ku përfshihet luftimi i krimit të organizuar, krimit ekonomik, korrupsionit etj.; (ii) siguria publike që ka të bëjë me operacione të ndryshme, komunikacioni rrugor, njësitë e specializuara etj.; (iii) kontrolli dhe menaxhimi i integruar i kufirit; (iv) shërbimet mbështetëse në kuadër të së cilës funksionon sektori i prokurimit, administrimi i pasurive dhe stotopeve, menaxhimi i buxhetit të PK-së dhe (v) burimet njerëzore në të cilën përfshihen rekrutimi, përzgjedhja, gradimi dhe shkarkimi i personelit të Policisë. Sa i përket çështjeve të rekrutimit, Plani i Integritetit i PK-së ka evidentuar se ka sfida, ndërsa për këto dy çështje do të flitet nën-seksionet pasuese.

¹⁵ (Policia e Kosovës, a, f. 4).

¹⁶ Po aty, f.6.

Një aspekt i rëndësishëm për qeverisjen e brendshme të Policisë është edhe transparenca. Sfida kryesore në këtë drejtim është mospublikimi i legjislacionit sekondar të Policisë (përfshirë rregullore ose udhëzime administrative që rregullojnë çështje të ndryshme të qeverisjes së këtij institucioni) në ueb-sajtin e kësaj të fundit. Pos ligjeve që kanë të bëjnë me funksionimin e PK-së, raporteve vjetore, strategjive përkatëse e disa dokumenteve të tjera, si dhe konkurseve për rekrutim e gradim, megjithatë në ueb-sajtin e PK-së mungojnë dokumentet nënligjore të cilat rregullojnë çështje të caktuara të Policisë (sic është rekrutimi, gradimi, prokurimi publik, mekanizmat e kontrollit të brendshëm policor. Mospublikimi i këtyre dokumenteve nënligjore që rregullojnë aspekte të ndryshme të PK-së e bën edhe më të vështirë vlerësimin e integritetit dhe qeverisjes së brendshme institucionale. Prandaj, PK-ja do të duhej t'i publikonte këto dokumente (bëhet fjalë për ato dokumente që përbëjnë interes publik dhe jo për ato dokumente që mund të kenë ndjeshmëri në aspektin e sigurisë) me qëllim të ngritjes së transparencës përballë publikut. Ndërsa, sa i përket komunikimit dhe informimit, në Pën e Integritetit thuhet se praktikata e komunikimit në Polici janë në përgjithësi transparente, por se ka hapësirë për përmirësim.¹⁷ Aty rekomandohet që PK-ja të jetë më pro-aktive për të garantuar transparencën e saj me kohë përballë kërkesave për informata nga mediat, organizatat joqeveritare dhe palët tjera, ndërsa kërkohet që personali përkatës policor të trajnohet në fushën e komunikimit dhe në mbrojtjen e të dhënave personale.¹⁸

2.1. Rekrutimi në Policinë e Kosovës

Të anketuarit janë pyetur edhe për çështjen e rekrutimit në PK, përkatësisht për procesin e punësimit në PK, përfshirë këtu stafin civil dhe atë të uniformuar. Se ka sfida në procesin e rekrutimit kjo është pranuar tërthorazi edhe nga vet PK-ja. Në Planin për Fuqizimin e Integritetit në PK 2018-2019 konstatohen fushat të cilat cenojnë integritetin policor dhe një ndër këto fusha është rekrutimi si pjesë e burimeve njerëzore të PK-së. Sipas këtij plani, me qëllim që të shmangen përshtypjet se personeli në PK zgjidhet në pozita të ndryshme mbi baza të favorizimit apo nepotizmit, është rekomanduar të ketë transparencë më të madhe në këtë proces. Në këtë dokument të PK-së përmendet që transparenca në punësim heq dilemat, perceptimet e gabuara dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ngritjen e imazhit dhe integritetit të Policisë.¹⁹ Për më tepër, në Planin e Integritetit të PK-së thuhet që duhet të parandalohet konflikti i interesit brenda PK-së me rastin e caktimit të paneleve gjatë proceseve të

17 Po aty, f. 12.

18 Po aty.

19 Po aty, f. 8.

rekrutimit.²⁰ Plani për Fuqizimin e Integritetit në PK ka nis të zbatohet në fillim të vitit 2018 dhe rrjedhimisht është ende herët të vlerësohet se deri në çfarë shkalle janë realizuar këto zotime të Policisë.

PK-ja e ka para vetes mundësinë të ngris transparencën dhe të zhvillojë edhe më shumë sistemin e meritës në procesin e rekrutimit në bazë të konkursit që e ka shpallur në prill të vitit 2018 për pranimin e zyrtarëve policorë, proces ky i rekrutimit ku pritet të pranohen rreth 250-300 zyrtarë të rinj policorë²¹. Një ndër kushtet e konkursit për ata që aplikojnë për zyrtarë policorë në PK është edhe kushti që kandidatët duhet të jenë të moshës prej 18 deri 30 vjeç. Duke e ditur që një pjesë e madhe e personelit të PK-së kanë moshë më të vjetër, përkatësisht mosha mesatare e pjesëtarëve të PK-së është rreth 43 vjeç, ky konkurs i shpallur dhe kushti i moshës i vendosur nga ana e PK-së duket se ka për qëllim që të rifreskojë personelin me zyrtarë policorë të rinj. Por, nuk dihet nëse ky konkurs është shpallur në kuadër të reformimit të PK-së si pasojë e procesit të pensionimit të parakohshëm të zyrtarëve policorë që kanë arritur moshën mbi 55 vjeç. Ajo që dihet është se ende nuk është miratuar Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policorë të Policisë së Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës. Ndërsa, ligji aktual për Policinë nuk garanton përfitim për zyrtarët që kërkojnë pensionimin e parakohshëm pas moshës 55 vjeç.

Në edicionet e BKS për vitin 2016 dhe 2017 të anketuarit kanë shprehur opinionet e tyre në lidhje me procesin e rekrutimit në Polici. Krahasimi i rezultateve përgjatë viteve tregon se në vitin 2017 të anketuarit kanë potencuar që ky proces ka gjasa të jetë më pozitiv në raport me vitin 2016. Siç ilustron në figurën e mëposhtme, rreth 35 përqind e të anketuarve në vitin 2017 ishin deklaruar se përzgjedhja e kandidatëve për punësim në PK bëhet përmes konkursit publik, derisa në vitin 2016 kishte trend më të ulët prej pesë përqind (gjithsej 30 përqind) të atyre që mendonin se punësimi në PK bëhet përmes konkursit publik.


Megjithatë, qytetarët kanë shprehur dyshimet e tyre se punësimi në polici ndikohet nga fenomene negative e të paligjshme gjë që mund të sjell deri te diskriminimi i kandidatëve për punësim në PK. Si në vitin 2016, por edhe në vitin 2017 rreth 31 përqind e të anketuarve kishin renditur lidhjet familjare ose nepotizmin si njëri nga mënyrat se si zhvillohet procesi i rekrutimit në këtë institucion. Përveç kësaj, sipas të anketuarve, edhe lidhjet politike luajnë rol të konsiderueshëm në gjetjen e një vendi pune në PK. Derisa më 2016 rreth 25 përqind e tyre mendonin se përmes lidhjeve politike bëhet rekrutimi në Polici, në vitin 2017 një perceptim ishte ulur për gjashtë përqind më pak me gjithsej 18 përqind të të anketuarve. Në fund është përmendur edhe ryshfeti si faktor që ndikon në punësimin e kandidatëve në institucionin e PK-së.

²⁰ Po aty, f. 10.

²¹ (Fejzullahu, 2018).

Duke i marrë parasysh këto rezultate të fundit, PK-ja do të duhej që gjithsesi të sigurojë transparencë më të theksuar sa i përket rekrutimit të personelit të ri (qoftë civil ose të uniformuar) për të shmangur çfarëdo dyshimi (nepotizmin, lidhjet politike, rryshfetin dhe faktorë të tjerë negativ) në përzgjedhjen e kandidatëve për punësim.

Figura 9 - Përzgjedhja e kandidatëve për punësim në Policinë e Kosovës



2.2. Korrupsioni në Policinë e Kosovës

Fenomeni i korrupsionit ka vazhduar ta sfidojë dhe cenojë rëndë integritetin e institucionit të PK-së gjatë këtyre viteve të fundit. Për më tepër, problemet me korrupsionin policor janë konstatuar edhe në Planin për Fuqizimin e Integritetit në Policinë e Kosovës 2018-2019. Aty thuhet se mekanizmat e kontrollit të brendshëm policor për parandalimin e korrupsionit policor janë të vendosura vetëm pjesërisht në kuadër të PK-së. Rrjedhimisht, do të duhej që kontrolli i brendshëm policor, gjegjësisht mekanizmat e brendshëm të PK-së për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit policor të forcohen me qëllim të zvogëlimit të rasteve kur zyrtarë të PK-së (pavarësisht gradave dhe pozitave që mbajnë) përfshihen në vepra të korrupsionit.

Pos kësaj, në këtë dokument përmendet se mungesa e një sistemi të fortë të kontrollit të brendshëm mund të ndikojë në uljen e integritetit në PK.²² Për më tepër, është e rëndësishme

22 (Policia e Kosovës, a, f. 9.).

të theksohet që PK-ja e ka pranuar që për raportimin, parandalimin dhe luftimin e veprave që ndërlidhen me korrupsion është e nevojshme të organizohen takime nga udhëheqësit me personelin policor me qëllim të parandalimit dhe luftimit të veprave penale korruptive.²³ Në Planin e Integritetit të PK-së ku flitet për luftën kundër korrupsionit thuhet qartë që për integritetin dhe korrupsionin duhet të diskutohet hapur në njësitë organizative të PK-së gjatë takimeve të rregullta si dhe përmendet nevoja e hartimit të planeve për trajnime dhe fushata për ngritje të vetëdijes për etikën dhe integritetin brenda Policisë.²⁴

Pavarësisht që Plani i Integritetit i PK-së e ka renditur korrupsionin si njëren prej fushave që cenon integritetin e brendshëm të institucionit, megjithatë kur bën fjalë për luftën kundër korrupsionit policor, ky plan nuk përmend edhe rolin e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për luftimin e kësaj dukurie negative në Polici. Dihet që ndër funksionet kryesore të IPK-së është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj.²⁵ Ndërkaq, sa i përket fuqizimit të integritetit në PK dhe luftimit të korrupsionit policor, IPK-ja ka të drejtë të kryejë hetimin e integritetit të punonjësve të PK-së sipas autorizimit nga ana e prokurorit.²⁶ Sipas legjislacionit në fuqi që rregullon punën e IPK-së, hetimi i integritetit është në funksion të ruajtjes së etikës dhe integritetit në kuadër të standardeve të larta profesionale brenda PK-së duke kontribuar në përpjekjet mbi kontrollin e korrupsionit, duke rritur cilësinë e shërbimit dhe rritjes e besimit të publikut ndaj PK-së.²⁷ Si rrjedhojë e mandatit ligjor të IPK-së për zhvillimin e integritetit të PK-së, Plani i Integritetit edhe pse është dokument i brendshëm i Policisë për zvogëlimin e dukurive të mundshme negative, të cilat mund të cenojnë integritetin e PK-së, megjithatë do të duhej të parashihte, qoftë edhe sipërfaqësisht rolin e IPK-së në raport me mbikëqyrjen e aktiviteteve të PK-së.

Policia e Kosovës i ka mekanizmat e vet të kontrollit të brendshëm përmes të cilëve mbikëqyrë, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve policor gjatë detyrës zyrtare. Këta mekanizma kanë të drejtë të hetojnë të gjitha rastet disiplinore për shkelje të rënda dhe të lehta deri në gradën e nënkolonelit policor, por jo edhe zyrtarët policor me grada më të larta dhe personelin ekzekutiv të Policisë. Ndërsa, hetimet për personelin që ka grada më të larta në PK dhe atë ekzekutiv të Policisë hetime ka të drejtë të ndërmerë IPK-ja. Inicimi i lëndëve disiplinore brenda PK-së ndaj personelit policor bëhet në tri mënyra: (i) përmes inicimit të brendshëm nga ana e mbikëqyrësit, (ii) me ankesë të qytetarit dhe (iii) sipas detyrës zyrtare. Përveç kësaj, mekanizmat policor të

23 Po aty.

24 Po aty.

25 Neni 2, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

26 Neni 20, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

27 Po aty.

kontrollit të brendshëm janë përgjegjës për shqyrtimin dhe shqiptimin e masave disiplinore për lëndët disiplinore që hetohen brenda PK-së.²⁸ Megjithatë, siç u përmend më herët, nuk dihet se si është e rregulluar fushë-veprimtaria e mekanizmave të kontrollit të brendshëm të PK-së për shkak se dokumentet që e rregullojnë këtë çështje nuk janë të publikuar në ueb-sajtin e PK-së. Publikimi i këtyre dokumenteve dhe i vendimeve të këtyre mekanizmave do të bënte të mundur që të analizohen në hollësi aktivitetet e kontrollit të brendshëm policor.

Korrupsioni në PK ka nisur të dalë më shumë në sipërfaqe dhe një shembull për këtë është arrestimi i 59 zyrtarëve policorë nën dyshimin e bazuar të veprës së korrupsionit në dhjetor të vitit 2016. Ky aksion ishte udhëhequr nga IPK-ja, ndërsa zyrtarët policorë të arrestuar ishin kryesisht nga rajoni i Prizrenit, Mitrovicës së jugut dhe Mitrovicës së veriut si dhe nga një-sia për kontrollin e autostradave nën dyshimin se kishin marrë ryshfet nga qytetarët.²⁹ Në raportin monitorues të QKSS-së për vitin 2017 është raportuar për këtë rast, ndërsa në këtë raport do të përfshihen edhe dy raste të tjera të ndjeshme ku zyrtarë të lartë policorë dyshohet se kanë qenë të përfshirë në vepra penale.

Njëri nga këto raste është ai i ish-drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), Emin Beqiri, i cili dyshohet se ka qenë i përfshirë në një aferë të rëndë korrupsioni në lidhje me mbylljen e hetimeve për korrupsion të një rasti penal në PK përmes ryshfetit. Për këtë rast, IPK-ja i kishte rekomanduar PK-së që si masë administrative të transferojë Beqirin nga pozita e drejtorit të DHKEK-së në zyrtar të administratës në Njësitin e Policisë Speciale dhe ky rekomandim ishte respektuar nga ana e Policisë.³⁰ Kjo masë administrative e IPK-së ishte e vlefshme deri në përfundim të procedurës hetimore që u zhvillua nga Prokuroria Speciale, e cila ka ngritur aktakuzë për këtë rast ndaj Beqirit dhe Rrahim Hashimit, një personi tjetër të dyshuar të përfshirë në këtë rast si ndërmjetës.³¹

Gjatë shqyrtimit të këtij rasti në Gjykatën Themelore në Prishtinë në maj të vitit 2018, të dy të akuzuarit (Beqiri dhe Hashimi) që dyshohen se u kishin marrë 100 mijë euro drejtuesve të organizatës Qendra për Avokim dhe Diplomaci për t'ua mbyllur një rast në PK, nuk e kanë pranuar fajësinë. Ata janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale. Derisa Beqiri ngarkohet me veprat penale "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", "pengim i të provuarit" dhe "moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre", nga ana tjetër, Hashimi akuzohet për veprat penale "ushtrim i ndikimit" dhe "mashtrim".³²

28 (Avdiu & Perteshi, 2016, f. 26).

29 (Kosova Press, 2016).

30 (Koha Net, 2017).

31 (Insajderi, 2018).

32 (Pergega, 2018).

Një rast tjetër i ndjeshëm kur zyrtarë lartë të PK-së u përfshin në dukuri negative ndodhi në dhjetor të 2017-tës, kur dy zyrtarë policorë rrahën dhe sulmuan fizikisht ish-drejtorin e VALA-s, Agron Mustafa në Prishtinë.³³ Njëri nga zyrtarët e lartë të PK-së i përfshirë në këtë aferë ka qenë ushtruesi i detyrës i drejtorit të DHKEK-së, Nazim Sahiti, i cili u emërua në këtë pozitë pas transferimit të ish-drejtorit Emin Beqiri në një pozitë tjetër brenda Policisë.³⁴ Kurse, zyrtari tjetër që kishte sulmuar Mustafën ishte polici në sektorin e luftimit të narkotikëve në Polici, Avni Berisha. Pas kësaj ngjarje, IPK-ja në kuadër të veprimeve hetimore për këtë rast i kishte rekomanduar PK-së të suspendojë policin Berisha dhe sipas IPK ka miratuar këtë masë duke suspenduar zyrtarin përkatës.³⁵ Sidoqoftë, në komunikatën ku bëhet fjalë për suspendimin e policit Avni Berisha, megjithatë nuk përmendet në asnjë rast edhe shefi i hetimit të krimeve ekonomike dhe korrupsionit, Nazim Sahiti, i cili sipas video-materialeve që janë publikuar, në bashkëveprim me policin Berisha, kishte marrë pjesë në sulmin fizik ndaj Mustafës.³⁶ Madje, IPK-ja nuk kishte rekomanduar suspendimin e tij si në rastin ndaj policit Berisha dhe as transferimin e tij në ndonjë pozitë tjetër brenda PK-së siç kishte vepruar me zyrtarin tjetër policor nën hetime, Emin Beqiri. Krahas këtyre zhvillimeve, Sahiti, sikurse disa zyrtarë të tjerë policorë, kishte dështuar të kalojë verifikimin e sigurisë nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë në vitin 2013.³⁷ Pavarësisht kësaj, ai ka vazhduar të ushtronte poste të rëndësishme në PK.

Motivet prapa sulmi fizik ndaj Mustafës ende nuk janë zbardhur, ndërsa hetimet ndaj Sahitit dhe Berishës është duke u zhvilluar Prokuroria. Hetimet i kishte nisur Prokuroria Themelore e Prishtinës, ndërsa më pas ato i janë transferuar Prokurorisë së Gjilanit.³⁸ Kjo ka ndodhur për shkak se Sahiti ka kërkuar nga Prokuroria e Apelit të Kosovës që rasti t'i transferohet Prokurorisë së Gjilanit dhe Prokuroria e Apelit ka miratuar një kërkesë të tillë.³⁹ Por, nuk dihen arsyet që e kanë shtyrë Sahitin të kërkojë transferimin e rastit të tij në një prokurori tjetër e po aq e pa qartë mbetet edhe baza ligjore mbi të cilën prokuroria e ka pranuar një kërkesë të tillë. Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritur aktakuzë ndaj policit Avni Berisha për veprën penale "lëndim i lehtë trupor".⁴⁰ Sipas raportimeve të mediave në Kosovë, aktakuza është ngritura nga Prokuroria vetëm ndaj Berishës, por jo edhe ndaj zyrtarit të tjetër policor, Sahiti, i përfshirë në rrahjen e ish-drejtorit të VALA-s, Mustafa.⁴¹

33 Shih video-materialin në këtë vegëz: <<https://www.youtube.com/watch?v=OOLvKu-a4Ac>>.

34 (Gazeta Express, 2018a).

35 (Inspektorati Policor i Kosovës, 2017).

36 Shih video-materialin në këtë vegëz: <https://www.youtube.com/watch?v=OOLvKu-a4Ac>.

37 (Gashi, 2018).

38 (Koha Net, 2018).

39 (Gashi, 2018).


40 (Bajraktari, 2018).

41 (Gazeta Express, 2018b).

Anketa e BKS për vitin 2017 është matur në tetor të vitit 2017, ndërsa ngritja e aktakuzës ndaj ish-drejtorit të DHKEK-së, Emin Beqiri dhe rasti i sulmit fizik ndaj Mustafës nga dy zyrtarët policorë (Sahiti dhe Berisha) kanë ndodhur disa muaj më vonë pas realizimit të anketave me të anketuarit. Prandaj, në kohën kur ishte realizuar BKS për vitin 2017 këto raste (ngritja e aktakuzës ndaj Beqirit dhe sulmi fizik i zyrtarëve policorë kundër Mustafës që pasoi me ngritje të aktakuzës po ashtu) nuk kishin ndodhur dhe rrjedhimisht ende nuk dihet nëse këto raste do të ndikojnë në zbehjen e imazhit të Policisë së përballë publikut dhe qytetarëve të vendit.

Sipas të anketuarve, korrupsioni brenda PK-së ka shënuar rritje në krahasim me vitet para-prake. Në vitin 2015 rreth 27 përqind e të anketuarve kishin deklaruar se PK është e korruptuar, ndërsa një vit më vonë ky perceptim kishte shënuar rënie në mënyrë dramatike: vetëm 11 përqind e të anketuarve kishin shprehur opinionin se Policia është e përfshirë në korrupsion. Mirëpo, në vitin 2017 hasen mendime krejtësisht të ndryshme me ato të vitit 2016 me rritje pothuajse të trefishtë të atyre që mendojnë se korrupsioni policor cenon integritetin e PK-së. Rreth 28 përqind e të anketuarve në vitin 2017 ishin shprehur se PK-ja është e përfshirë në korrupsion. Siç shihet në tabelën e mëposhtme, rezultati më pozitiv ishte në vitin 2016 kur shumica dërmuese e të anketuarve ndanin opinionin se PK-ja nuk është e korruptuar (rreth 68 përqind), ndërsa trendi më negativ, sipas rezultateve, ishte në vitin 2017 (ku vetëm 39 përqind e tyre kishin mendim që PK-ja nuk është e përfshirë në korrupsion).

Figura 10 - Korrupsioni në Policinë e Kosovës




Në kuadër të anketës së zhvilluar përmes BKS të anketuarit kanë pasur mundësi të shprehin qëndrimet e tyre edhe për shkallën e përhapjes së korrupsionit në sektorë të ndryshëm brenda PK-së, kryesisht me ato sektorë që kanë kontakte të drejtpërdrejta me qytetarë. Përfshirje në këtë rast bën menaxhmenti i lartë i PK-së që përkundër se nuk zhvillon kontakte me qytetarë në krahasim me Policinë e Trafikut dhe Policinë Kufitare, megjithatë është vendosur si opsion në pyetësor duke marrë parasysh që menaxhmenti i Policisë është organi më i lartë vendimmarrës për çështje që i përkasin qeverisjes së institucionit.

Rezultatet kanë treguar se sipas të anketuarve menaxhmenti i PK-së në vitin 2016 dhe 2017 është segmenti ku më së shumti është i përhapur korrupsioni policor. Në vitin 2016 rreth 33 përqind e të anketuarve ishin deklaruar se menaxhmenti i Policisë është i korruptuar, ndërsa në vitin 2017 kishte një zvogëlim për dy përqind më pak me gjithsej 31 përqind të të anketuarve që ndanin mendimin se ky sektor është i korruptuar. Policia Kufitare e ndjek nga pas me përqindje menaxhmentin e PK-së, përkatësisht në vitin 2017 vërehet një rënie e perceptimit për korrupsionit në këtë sektor të PK-së nga 31 përqind më 2016 në 30 përqind më 2017.

Ndërsa, sektori më së paku i korruptuar ka dalë të jetë Policia e Trafikut, megjithëse trendi ndërmjet vitit 2016 dhe 2017 nuk tregon se fenomeni i korrupsionit është në rënie. Kjo për shkak se derisa në vitin 2016 rreth 26 përqind e të anketuarve ishin shprehur se Policia e Trafikut është e korruptuar, në vitin 2017 perceptimi për shkallën e korrupsionit në këtë njësi të PK-së ishte rritur për tre përqind (29 përqind gjithsej).

Figura 11 - Korrupsioni në njësitë e Policisë së Kosovës




2.3. Perceptimet e qytetarëve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit policor

Perceptimi i qytetarëve për nivelin e përhapjes së korrupsionit në institucionin e PK-së shtron nevojën urgjente për ndërmarrjen e masave adekuate për parandalim dhe luftim të korrupsionit policor. Të anketuarit janë pyetur se cili do të ishte institucionit i parë të cilit do t'i drejtoheshin për raportimin e rasteve të korrupsionit në PK. Sipas rezultateve të BKS për tri vitet e fundit, adresa e parë e qytetarëve për raportimin e korrupsionit policor do të ishte stacioni më i afërt policor dhe kjo vlen për të tria vitet kur janë pyetur qytetarët (2015, 2016 dhe 2017) edhe pse me disa dallime të lehta në përqindje ndërmjet këtyre viteve. Në vendin e dytë është Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), e cila pasohet nga mediat të cilat qytetarët do të raportojnë korrupsionin e Policisë.

Institucioni kyç për raportimin e korrupsionit policor nga qytetarët padyshim që është IPK-ja. Por, ky institucion është radhitur i katërti nga të anketuarit si adresë ku do të drejtoheshin për raportim të ndonjë rasti të korrupsionit në PK. Megjithatë, përgjatë periudhës së këtyre tri viteve (2015-2017) vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve - prej 13 deri 14 përqind - do të zgjedhin këtë institucion për të raportuar korrupsionin policor.

Ndërsa, mekanizmat tjera të radhitur më poshtë janë komandanti i stacionit policor, Prokuroria e Shtetit dhe organizatat jo-qeveritare.

Figura 12 - Kujt së pari do t'i raportoni për korrupsion në Policinë e Kosovës?




Sa i përket luftimit të korrupsionit brenda PK-së qytetarët edhe në vitin 2017 sikurse në vitet para-prake presin nga institucionet politike të dëshmojnë vullnet politik për luftimin ose zvogëlimin e shkallës së korrupsionit jo vetëm në Polici, por edhe në institucionet tjera. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës, sipas të anketuarve, është renditur si institucioni i parë dhe kryesor që duhet t'i prijë luftës kundër korrupsionit policor. Gjatë viteve 2015-2017 përqindja e të anketuarve që mendojnë se Qeveria duhet të luftojë korrupsionin ka lëvizuar kryesisht prej 28 deri 30 përqind.

AKK-ja është renditur si institucioni i dytë që do të duhej të angazhohej për luftimin e korrupsionit brenda Policisë. Mbi 20 përqind e të anketuarve kur janë pyetur gjatë tri viteve të fundit kanë shprehur qëndimin e tyre se ky institucion duhet të luftojë korrupsionin policor me përjashtim të vitit 2016 kur 17 përqind të qytetarëve të anketuar e kishin renditur si institucionin e tretë në luftën kundër korrupsionit në PK.

Çuditërisht IPK-ja sërish ka mbetur prapa kur bëhet fjalë për luftimin e korrupsionit në PK. Përveç vitit 2016 kur 21 përqind e të anketuarve e kishin vënë si mekanizmin e dytë pas Qeverisë për luftimin e dukurive korruptive në Polici, në vitin 2015 dhe 2017 vetëm 18 përqind prej tyre deklarorin se IPK-ja duhet të luftojë korrupsionin policor. Këto rezultate mbase tregojnë që IPK-ja duhet të jetë më aktive kur bën hetime të veprave penale ndaj punonjësve të Policisë ashtu siç i takon me legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe rastet e korrupsionit, në mënyrë që të dal më tepër në sipërfaqe roli i këtij institucioni për ngritjen e integritetit të PK-së. Kjo do të mund të ndikonte që qytetarët të jenë më të informuar për funksionin e IPK-së dhe bashkëpunimi i IPK-së me qytetarët do të forcohej me qëllim të parandalimit, raportimit, zvogëlimit dhe luftimit të korrupsionit policor.

Ndërsa, institucionet tjera për të cilat të anketuarit mendojnë se duhet ta luftojnë korrupsionin, si PK-ja, Prokuroria e Shtetit, Ministria e Punëve të Brendshme, Sindikata e PK-së dhe bashkësia ndërkombëtare kanë marrë përqindje dukshëm të ulëta lidhur me luftimin e korrupsionit policor. Edhe pse Prokuroria e Shtetit është institucioni kryesor i zbatimit të ligjit që ka për detyrë luftimin e korrupsionit edhe në PK, trendët e viteve të fundit kanë treguar se vetëm 8 ose 9 përqind e të anketuarve ia besojnë këtij institucionit luftën kundër korrupsionit policor. Kjo ka të bëjë edhe me besueshmërinë e ulët që e gëzojnë institucionet e sektorit të drejtësisë (gjykatat dhe prokuroria) te qytetarët e vendit tashmë disa vite.⁴²


42 (Vrajolli, 2018, f. 15-17).

Figura 13 - Kush duhet ta luftojë korrupsionin në Policinë e Kosovës?

Profesionalizmi dhe fuqizimi i integritetit policor ndodh atëherë kur mekanizmat e kontrollit të brendshëm të PK-së dhe institucionet tjera të zbatimit të ligjit funksionojnë në mënyrë të duhur për adresimin e ankesave dhe shqetësimeve të ngritura nga ana e qytetarëve. Në pyetjen se kujt do t'i drejtoheshin qytetarët për t'u ankuar nëse punonjësit e PK-së kanë bërë shkelje disiplinore, të anketuarit kanë renditur në vendin e parë IPK-në. Në vendin e dytë është PK-ja (nga 24 përqind në vitin 2016 në 23 përqind më 2017) në veçanti mekanizmat e saj të kontrollit të brendshëm që merren me shkeljet disiplinore të shkaktuara nga punonjësit e Policisë.

Po ashtu, një funksion të rëndësishëm për raportimin e shkeljeve të disiplinore të zyrtarëve policorë, të anketuarit i shohin edhe te mediat të cilave do t'ju drejtoheshin në rast se kanë informacione për shkeljet disiplinore të personelit policor (nga 18 përqind më 2016 në 16 përqind më 2017). Ndërkaq, institucionet tjera në përqindje më të vogël janë Ministria e Punëve të Brendshme, AKK-ja dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit – EULEX.

Figura 14 - Kujt do t'i drejtoheshit për t'u ankuar nëse keni informacione se policët kanë bërë shkelje disiplinore?



2.4. Mbrojtja e interesit publik nga Policia e Kosovës


Siç është e rregulluar edhe me ligj, veprimet e PK-së udhëhiqen nga parimet e integritetit, ndershmërisë dhe përgjegjësisë në shërbimin publik.⁴³ Për këtë arsye të anketuarit kanë pasur mundësinë të japin mendimet e tyre lidhur me atë se në shërbim të kujt është institucioni i Polici së.

Trendët e regjistruara në BKS tregojnë që më shumë se 50 përqind e të anketuarve që prej vitit 2015 mendojnë se PK-ja u shërben interesave të publikut dhe qytetarëve të Kosovës. Për më tepër, nga viti 2015 deri në vitin 2017 ka pas një ngritje progresive në këtë aspekt nisur nga fakti që derisa në vitin 2015 rreth 58 mendonin se PK-ja punon për qytetarët, në vitin 2016 kjo përqindje kishte qëndruar në 58 përqind, kurse më 2017 në 64 përqind. Këto rezultate tregojnë se më 2017 ishte shënuar rritja më e madhe në mesin e të anketuarve që mendonin se Policia punon në shërbim të qytetarëve.

⁴³ Neni 2, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

Nga ana tjetër, sipas të anketuarve edhe pse ka mundësi që PK-ja t'u shërbejë interesave të Qeverisë së Kosovës, megjithatë ky trend është në rënie kur rezultatet krahasohen ndërmjet viteve. Më 2015 rreth 23 përqind e të anketuarve kishin shprehur mendimin se PK-ja i shërben Qeverisë, por në vitin 2016 kjo kishte rënë në 18 përqind dhe më 2017 në 13 përqind. Rezultate pozitive PK-ja ka arritur edhe kur të anketuarit janë pyetur në rast se ky institucion i shërben subjekteve politike në Kosovë ku po ashtu vërehet rënie në perceptim të atyre që mendojnë se PK është në shërbim të partive politike (më 2015 dhe 2016 ishin rreth 12 përqind, ndërsa në vitin 2017 në 10 përqind, gjegjësisht për dy përqind më pak). Megjithëse me përqindje më të vogël, një pjesë e të anketuarve mendojnë se PK-ja i shërben interesave të ngushta klanore dhe ky mendim duket se ka një rritje të lehtë nga viti në vit (më 2015 në 6 përqind kishte pasur rritje për dy përqind më tepër më 2016 me 8 përqind dhe një rritje të lehtë më 2017 në 9 përqind gjithsej). Ndërkaq, të anketuarit mendojnë se PK-ja më së paku i shërben interesave të menaxhmentit të lartë të PK-së ku ka një rënie të perceptimit të tyre se PK-ja punon në favor të menaxhmentit të saj.

Figura 15 - Kujt i shërben Policia e Kosovës?



SHTOJCA MBI METODOLOGJINË

- Barometri Kosovari i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) që është themeluar në shtator të vitit 2012.
- Fokusi parësor i BKS-së është matja e besueshmërisë së publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë, si dhe matja e perceptimit të qytetarëve për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë në Kosovë.
- BKS-ja është punimi i parë dhe më i madh i këtij lloji i projektuar, zbatuar dhe komunikuar nga një qendër studimore vendore në Kosovë.
- BKS-ja ka neutralitetin politik. Si qendër studimore e pavarur, QKSS-ja nuk ka kufizime politike në komunikimin e ndonjë prej gjetjeve dhe porosive të anketës.
- BKS-ja kombinon metodat sasiore dhe cilësore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme.
- Të dhënat mbledhen përmes intervistave sy më sy me të anketuarit e përzgjedhur rastësisht në të gjithë Kosovën nga hulumtuesit e QKSS-së në terren.
- Pyetësi i BKS-së përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura që u lejojnë të anketuarve të japin mendimet.
- Mostrimi, pilotimi dhe intervistat janë realizuar nga 22 hulumtues në terren të ekipeve të QKSS-së. Mostra kombëtare nga e cila u hartua hulumtimi paraqet 1,125 ekonomi familjare, pas mostrimit përfaqësues të popullsisë mbi 18 vjeç në Kosovë.
- Ndarja etnike e të anketuarve që janë intervistuar është si në vijim: 90 përqind shqiptarë, 7 përqind serbë dhe 3 përqind nga komunitetet tjera (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptianë, goranë, kroatë dhe malazezë), duke pasqyruar përbërjen etnike të Kosovës.
- Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodit telefonik dhe si të tilla përfshinë këto tetë rajonit të Kosovës: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.
- Faza e parë e grupimit gjeografik u bazua në Raportin e Regjistrimit të Kosovës të vitit 2012. Faza e dytë përfshiu grupimin e mostrave sipas zonës së komunës me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Në fazën e fundit u përdor metoda e mostrës së rastësishme duke përdorur metodën e datëlindjes më të afërt të të anketuarve.
- Marrja e mostrave të rastit siguron që çdo banor në Kosovë ka probabilitet të barabartë për të qenë i zgjedhur për një intervistë. Duke pasur parasysh mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë prirjet në qëndrimet dhe perceptimet në mesin e të gjithë popullsisë së rritur në Kosovë në përgjithësi. Marzhi i gabimit është 3 për qind me një interval besueshmërie prej 95 për qind.
- Para fillimit të punës në terren u krye një intervistë pilot në shtator të vitit 2017 për të testuar realizueshmërinë e pyetësorit. Më pas, ekipi hulumtues raportoi se intervista pilot ishte e suksesshme dhe nuk kishte probleme me instrumentin pilot. Të gjitha intervistat u kryen nga 5 deri më 11 tetor 2017. Përpunimi dhe analiza e të dhënave u realizua duke përdorur softuerin SPSS.
- Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të mbledhura nga të anketuarit dhe dëshmojnë mënyrën se si ata i perceptojnë institucionet e Kosovës.

BIBLIOGRAFIA

- Avdiu, P., & Perteshi, S. (2016). *Raport monitorues dhe vlerësues: Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit në institucionet e sigurisë në Kosovë*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
- Bajraktari, L. (23 Maj 2018). *Ngritet aktakuzë për lëndim të lehtë trupor ndaj policit që u përfshi në rrahjen e Agron Mustafës*. Gjetur në Betimi për Drejtësi: <http://betimiperdrejtesi.com/ngritet-aktakuze-per-lendim-te-lehte-trupor-ndaj-policit-qe-u-perfshi-ne-rrahjen-e-agron-mustafes/>
- Fejzullahu, A. (5 Maj 2018). *Smakiaqi: Do të pranojmë në polici më të mirët e mundshëm*. Gjetur në Kallxo.com: <http://kallxo.com/smakiaqi-do-te-pranojme-ne-polici-me-te-miret-e-mundshem/>
- Gashi, B. (1 Shkurt 2018). *Shefi i Policisë që rrahu Agron Mustafën dirigjon Prokurorinë, e dërgon në Gjilan rastin e tij*. Gjetur në Gazeta Express: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/shefi-i-policise-qe-rrahu-agron-mustafen-dirigjon-prokurorine-e-dergon-ne-gjilan-rastin-e-tij-494319/>
- Gazeta Express. (22 Mars 2018a). *Kthehet nga jashtë ekspertiza për zërin e ish-shefit të krimeve ekonomike*. Gjetur në Gazeta Express: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/kthehet-nga-jashte-ekspertiza-per-zerin-e-ish-shefit-te-krimeve-ekonomike-514959/>
- Gazeta Express. (23 Maj 2018b). *Aktakuzë ndaj policit "Tarkani" që e rrahu Agron Mustafën*. Gjetur në Gazeta Express: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/aktakuze-ndaj-policit-tarkani-qe-e-rrahu-agron-mustafen-539758/>
- Insajderi. (4 Maj 2018). *Aktakuzë ndaj sekserit dhe ish-drejtorit të financave në Policinë e Kosovës*. Gjetur në Insajderi: <http://www.insajderi.com/aktakuze-ndaj-sekserit-dhe-ish-drejtorit-te-financave-ne-policine-e-kosoves/>
- Inspektorati Policor i Kosovës. (31 Dhjetor 2017). *Suspendohet zyrtari policor i përfshirë në incidentin e djeshëm*. Gjetur në Inspektorati Policor i Kosovës: <http://ipk.rks-gov.net/suspendohet-zyrtari-policor-i-perfshire-ne-incidentin-e-djeshem/>
- Koha Net. (18 Gusht 2017). *Emin Beqirit i ndërrohet vendi i punës deri në përfundimin e hetimeve kundër tij*. Gjetur në Koha Net: <https://www.koha.net/arberi/38605/emin-beqirit-i-nderrohet-vendi-i-punes-deri-ne-perfundimin-e-hetimeve-kunder-tij/>
- Koha Net. (23 Janar 2018). *Prokuroria e Apelit rastin e Nazim Sahitit e transferon në Prokurorinë e Gjilanit*. Gjetur në Koha Net: <https://www.koha.net/arberi/70918/prokuroria-e-apelit-rastin-e-nazim-sahitit-e-transferon-ne-prokurorine-e-gjilanit/>
- Kosova Press. (19 Dhjetor 2016). *Konferencë për arrestimin e policëve (Drejtëpërdrejt)*. Gjetur në Kosova Press: <https://www.youtube.com/watch?v=i63H56rdkeM>
- Kosova Press. (2018). *Ekskluzive: Raporti i krerëve të Policisë ku flitet për veriun (Dokument)17/*. Gjetur në Kosova Press: <http://www.kosovapress.com/sq/siguri/-160317/>

- Muji, A., & Avdiu, P. (2017). *Raport vlerësues dhe monitorues: Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit në institucionet e sigurisë në Kosovë*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
- Pergega, S. (16 Maj 2018). *Ish-drejtori i Krimeve Ekonomike dhe biznesmeni deklarohen të pafajshëm për mbylljen e një rasti për 100 mijë euro*. Gjetur në Betimi për Drejtësi: <http://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-krimeve-ekonomike-dhe-biznesmeni-deklarohen-te-pafajshem-per-mbylljen-e-nje-rasti-per-100-mije-euro/>
- Perteshi, S. (2018). *Udhëzues për gazetar: Ekstremizmi i dhunshëm*. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
- Policia e Kosovës. (a). *Plani për Fuqizimin e Integritetit në Policinë e Kosovës 2018-2019*. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë - Policia e Kosovës.
- Policia e Kosovës. (b). *Raporti Vjetor 2017*. Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore/Spektori për Planifikim Strategjik - Policia e Kosovës.
- Vrajolli, M. (2018). *Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i shtatë*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.74(496.51)(048)

Trendët e perceptimeve të qytetarëve për Policinë e Kosovës kundrejt realitetit (2015-2018) /

Interpretimi i të dhënave Plator Avdiu. Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2018. – 36 f. : ilustr. ; 21 cm.

1.Avdiu, Plator

ISBN 978-9951-679-78-7

ISBN 978-9951-679-78-7



9 789951 679787

www.qkss.org